

Ac.nr.3392/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit , Fejzullah Rexhepi dhe Albert Zogaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit A.K. nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson N.B. avokat në Vushtrri, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K”, me seli në Prishtinë, për kompensim të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore ne Mitrovicë-Dega ne Vushtrri, C.nr.466/10 i datës 24.09.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me date 12.07.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. VERTETOHET pika I dhe II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore ne Mitrovicë-Dega ne Vushtrri, C.nr.466/10 i datës 24.09.2013, në pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësit që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike të përjetuara, frikës së përjetuar dhe kompensimin e dëmit material në emër të perkujdesjes nga personi tjetër, me çka ankesa e të paditurës për këtë pjesë **REFUZOHET** si e pabazuar.

II. Me aprovimin e pjesëshëm të ankesës së të paditurës, **NDRYSHOHET** pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore ne Mitrovicë-Dega ne Vushtrri, C.nr.466/10 i datës 24.09.2013, në pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësit që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material në emër të ushqimit të përforcuar, rehabilitimit fiziko-terapeutik, shpenzimeve të shërimit dhe kamatës së gjykuar, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim:

-DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “K”, me seli në Prishtinë që paditësit A.K. nga Vushtrria, në emër të ushqimit të përforcuar ne kohëzgjatje prej 21 ditësh t’ia paguaj shumën prej 105 euro dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit t’ia paguaj shumën prej 4 euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë se paditësit lidhur më këtë kategori të dëmit mbi shumën e gjykuar, duke përfshirë edhe kërkesën për kompensim e dëmit material në emër të rehabilitimit fiziko-terapeutik, refuzohet si e pabazuar.

-DETYROHET e paditura, që paditësit shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material dhe material, t’ia paguaj me kamatë të cilën e llogarisin Bankat Afariste ne Kosovë për mjetet e deponuara të qytetarëve mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 24.09.2013 e gjer në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit.

III. Pika III dhe IV e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega ne Vushtrri, më aktgjykimin e atakuar C.nr.466/10 i datës 24.09.2013, me pikën I (një) të dispozitivit ka vendosur qe të aprovojë pjesërisht kërkespadsinë e paditësit A.K.. Me pikën II (dy) të dispozitivit ka vendosur qe të obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve "K" me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar ne Aksidentin e datës 29.09.2009, t'ia paguaj paditësit A.K. nga Vushtrria shumën totale prej 3.070 euro (tremijë e shtatëdhjetë euro) , të gjitha këto më kamatë qe paguhet sipas lartësisë në mjetet e deponuara në bankat afariste për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë 17.11.2009 e gjer në pagesën definitive dhe atë: në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumën prej 1.300 euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1.200 euro, në emër të ushqimit të përforcuar për kohëzgjatje prej 21 ditësh shumën prej 200 euro, në emër të përkujdesjes nga personi tjetër shumën prej 200 euro, në emër të rehabilitimit fiziko-terapeutik shumën prej 150 euro dhe në emër të shpenzimeve të shërimit shumën prej 20 euro. Me pikën III të dispozitivit ka vendosur qe të obligohet e paditura qe në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditësit shumën totale prej 743,64 euro (shtatëqind e katër dhjetë e tre euro e gjashtëdhjetë e katër cent) dhe atë: në emër të përpilimit të padisë nga i autorizuari i paditësit shumën prej 93.60 euro, në emër të taksës për padi shumën prej 25 euro, në emër të precizimit të kërkesëpadisë shumën prej 60 euro, në emër të dy ekspertizave mjekësore (ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë) shumën prej 200 euro, për secilën ekspertizë nga 100 euro, në emër të 3 seancave për përfaqësim nga i autorizuari i paditësit, shumën prej 365.04, për secilën seancë shumën prej 121.68 euro si dhe në emër të taksës gjyqësore për përpilim të aktgjykimit shumën prej 25 euro , të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm. Ndërsa me pikën IV të dispozitivit ka vendosur qe pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, refuzohet si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

I autorizuari i paditësit nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, duke analizuar dhe vlerësuar aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, konform dispozitës ligjore te nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës të cilën për se fundi herë e ka precizuar me parashtresën e datës 28.06.2013, me bazë kompensimin e dëmit material dhe jo material nga baza e auto përgjegjësisë, të cilin dëm e ka pësuar paditësi me rastin e aksidentit të

komunikacionit të ndodhur më datë 29.09.2009 në Mitrovicë, i cili aksident ishte shkaktuar me fajin e të siguruarit të të paditurës F.K. nga Mitrovica, i cili është shpallur përgjegjës më aktvendimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje ne Mitrovicë, Regj.I.nr. 8747.09 i datës 20.10.2010.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën zhvilloi procedurën dhe administroi provat nga shkresat e lëndës ku pas analizimit dhe vlerësimit të tyre, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar më për afërsisht si ne arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, në bazë të së cilës gjendje faktike duke zbatuar normat e së drejtës materiale, mori aktgjykimin e atakuar C.nr.466/10 i datës 24.09.2013, duke vendosur me decidivisht si ne dispozitiv të te njëjtit, ashtu siç Gjykata e Apelit e përshkroi më lartë ne pasusin e parë të arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Duke u nisur nga gjendja faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë sipas aktgjykimit të ankimuar, Gjykata e Apelit e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar ne mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, e cila ka mbështetje ne provat nga shkresat e lëndës, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar ne pjesën aprovuese të kërkesëpadiisë lidhur dëmin jo material qe i referohet dhimbjeve fizike të përjetuara dhe frikës së pësuar nga ana e paditësit, ngase edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit shumat e gjykuara për këtë lloj dëmi janë në përputhje të plotë me natyrën e shpërblimit, duke pasur parasysh rëndësinë e shkallës së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim ashtu siç është paraparë me nenin 200 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD), duke mos favorizuar synimet qe nuk përkojnë me natyrën dhe qëllimet për të cilat shërben ky shpërblim.

Sipas Gjykatës së Apelit të Kosovës, gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar ne mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale edhe sa i përket pjesës aprovuese të kërkesëpadiisë qe ka të bëjë më dëmin material, në emër të përkujdesjes nga personi tjetër, ngase në bazë te ekspertizës se ekspertit ortoped-traumatolog, rezulton se paditësi si pasojë e natyrës së lëndimeve të marra nga aksidenti, ka pasur nevojë për përkujdesje nga personi tjetër në kohëzgjatje prej 14 ditësh, qe rezultojnë me humbje materiale të paditësit, pa marrë parasysh se përkujdesjen ka mundur ta ushtron ndonjë familjar i tij apo edhe person tjetër jashtë familjes se tij i cili më kompensim është angazhuar qe të përkujdeset për paditësin gjatë kësaj kohe. Shuma e gjykuar paditësit për këtë lloji dëmi ka mbështetje ne dispozitën e nenit 185, 193 dhe 195 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD) dhe është në përputhje me praktikën e gjykatave të Kosovës, të cilat gjithnjë marrin si pikënisje pagën të cilën e realizon një infermier për punën e tij ne institucionet shëndetësore të Republikës së Kosovës, e cila diku për afërsisht është mbi 400 euro neto ne muaj, me çka ne rastin konkret po qe se përkujdesjen ndaj paditësit do ta ushtronte një infermier për 14 ditë aq sa ka pasur nevojë paditësi, i bie qe paditësit do ti duhej të paguante minimum gjysmë page të një infermieri.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nuk ka mundur ta pranojë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me pjesën aprovuese të kërkesëpadiisë që ka të bëjë me dëmin material qe i referohet shpenzimeve të mjekimit, ushqimit të përforcuar, rehabilitimit fiziko-terapeutik dhe kamatës ligjore të njohur paditësit ne shumat e gjykuara për faktin se përkundër asaj qe gjykata e

shkallës së parë drejtë ka vërtetuar faktin se paditësit i janë shkaktuar shpenzime lidhur me mjekimin e tij dhe ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, shuma prej 20 euro e cila i është gjykuar paditësit në emër të shpenzimeve të mjekimit, pjesërisht ka mbështetje në shkresat e lëndës, pasi që nga dëftesa më numër A0039720 e datës 29.09.2009 e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë në Prishtinë, rezulton se paditësi për mjekimin e tij ka paguar vetëm shumën prej 4 euro, e jo ndonjë shumë më të madhe. Sipas kësaj gjykate nuk përjashtohet mundësia që paditësit ti jenë shkaktuar edhe shpenzime tjera lidhur me mjekimin e tij, por i njëjti me rastin e mbajtjes se shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë nuk ka prezantuar prova konkrete për shpenzime tjera të bëra përtej shumës prej 4 euro.

Sa i përket shumës prej 200 euro të gjykuar paditësit nga gjykata e shkallës së parë në emër të ushqimit të përforcuar, edhe përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë me provat e nxjerra drejtë ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 21 ditësh, sipas Gjykatës së Apelit duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësi, cili lloji i ushqimit shtesë përveç ushqimit të zakonshëm çdo ditë i është nevojitur paditësit, por edhe praktikën e gjertanishme të Gjykatave të Kosovës rreth kompensimit të njohur për këtë lloji dëmi, kësaj gjykata i ka rezultuar se për ushqim shtesë ditor paditësi ka mundur të shpenzon mesatarisht çdo ditë nga 5 euro, me çka kur merret kohëzgjatja prej 21 dite, i bie që paditësi ka për ushqim të përforcuar gjatë kësaj kohe ka mundur të shpenzon rreth 105 euro, e jo ndonjë shumë më të madhe. Tek ky përfundim Gjykata e Apelit ka ardhur edhe për faktin tjetër se në shumicën dërmuese të rasteve kur kemi të bëjmë më lëndime të lehta trupore, ekspertët e lëmvive përkatëse në mendimet e tyre profesionale kanë përcaktuar se maksimumi që një të dëmtuari apo të lënduari brenda një dite i nevojiten apo mund të shpenzon për ushqim të përforcuar është shuma nga 4-6 euro.

Sa i përket shumës prej 150 euro të cilën gjykata e shkallës së parë paditësit ja ka njohur në emër të rehabilitimit fiziko-terapeutik, një konkludim të tillë si të rregullt dhe të ligjshëm nuk e gjen Gjykata e Apelit, për faktin se ky lloji dëmi i gjykuar nuk ka mbështetje në shkresat e lëndës, pasi që me asnjë provë nuk vërtetohet se paditësit i është shkaktuar ky lloji dëmi. Edhe përkundër asaj që me anë të ekspertizës së ekspertit nga lëmi i ortopedisë-traumatologjisë rezulton se paditësi ka pasur nevojë për rehabilitim fizioterapeutik-klimatik në kohëzgjatje prej 2 herë nga 7 ditë, sipas Gjykatës së Apelit paditësi ka pasur për obligim ligjor që të prezantoj dëshmi konkrete, faturë apo kupon fiskal, se i është shkaktuar ky lloji dëmi aq më tepër kur ky lloji rehabilitimi bëhet në klinika përkatëse nga të cilat mund të sigurohet dëshmi lidhur me çfarëdo pagesë të bërë, gjë të cilën paditësi ka mundur ta bënte nëse do të i ishte shkaktuar ky lloji dëmi.

Mbi këtë gjendje faktike të konstatuar nga Gjykata e Apelit, kjo gjykatë aktgjykimin e ankimuar në këtë pjesë e ndryshoi, duke i gjykuar paditësit në emër të dëmit material lidhur me mjekimin e tij shumën prej 4 euro dhe për ushqim të përforcuar shumën prej 105 euro, ku këto shuma të gjykuara paditësit për këtë lloji dëmi kanë mbështetje në dispozitën e nenit 185, 193 dhe 195 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD), ndërsa sa i përket kërkesës së paditësit lidhur me rehabilitimin fiziko-terapeutik, për këtë lloji dëmi gjykata kërkesëpadinë e

paditësit e refuzoj në tërësi si të pabazuar, pasi që paditësi me asnjë provë nuk ja ka bërë të besueshme gjykatës se i është shkaktuar ky dëm.

Sa i përket kamatës ligjore të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare por duke pasur parasysh edhe ankesën e palës së paditur, në këtë pjesë po ashtu ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar, ku kamata në shumat e gjykuara paditësit i është njohur në përputhje me dispozitën e nenit 277 të LMD, dhe atë duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit të ankimuar, datë 24.09.2013, pasi që paditësi për dëmin dhe llojin e dëmit të pësuar nga aksidenti i ndodhur ka mësuar pas nxjerrjes së provës me ekspertim mjekësor nga lëmi i ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë, e jo me herët.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK për të cilat gjykata e ankimit kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe nuk përmban as shkelje tjera procedurale sipas pretendimeve ankimore të palës së paditur përmes ankesës së ushtruar.

Gjykata e Apelit më rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka pasur parasysh të gjitha pretendimet ankimore të palës së paditur përmes ankesës së ushtruar, ku me aprovimin e pjesshëm të tyre edhe ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar, duke vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa për atë pjesë të pretendimeve ankimore të palës së paditur të cilat nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Apelit, kjo gjykatë ka gjetur se janë të pathemelta dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe.

Pikën III dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, Gjykata e Apelit nuk i ka shqyrtuar fare me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi pasi që nuk janë atakuar nga e paditura përmes ankesës së ushtruar.

Prandaj, nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të nenit 195.1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 200 dhe 201 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3392/2013, datë 12.07.2016

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,

Qerim Ademaj